



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planiar / Doretuar Punëno/Prodato Received/Delivered	01.12.2023	3	viti god year
Organ /Nesta Organ /Institucia Org /Unit	Hr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK/7201/2023			1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.431/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Eshref Shabani- anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.431/2019, të datës 26.07.2019, të ankueses duke shqyrtuar ankesën sipas parashtrësës së datës 19.10.2023, nga përfaqësuesi i autorizuar i ankueses, Avokat me adresë banimi rruga

kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 01.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet ankesa A.nr.431/2019 e datës 26.07.2019 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi, vendimi nr.14-070/01-132622/19 i datës 27.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.

III. Shfuqizohet Vendimi A.nr.431/2019 i datës 11.10.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes së cilit vendim ishte pezulluar procedura në lidhje me ankesën A.nr.431/2019 të datës 26.07.2019.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses Udhëheqësja e Drejtpërdrejtë R.G përmes shkresës/raportit me numër protokolli 14-116/01-57790/19 të datës 14.03.2019, ka bërë njoftimin për shkelje të rëndë

disiplinore bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nga ana e ankueses , tek Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, përmes vendimit me nr. numër protokollit 14-118/02-81634/19 të datës 08.04.2019, ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore „Ndërprerjeje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil”.

Ankuesja _____ e pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor me nr. numër protokollit 14-118/02-81634/19 të datës 08.04.2019, me datë 10.06.2019, ka parashtruar ankesë tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës, përmes vendimit me numër protokollit 14-070/01-132622/19 të datës 27.06.2019, ka nxjerr vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses _____ si të pa bazuar në ligj.

Ankuesja _____ e pakënaqur me vendimin me numër protokollit 14-070/01-132622/19 të datës 27.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës më datë 26.07.2019 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës së përgjithshme administrative dhe shkelje të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes njoftimit me numër protokollit 4045/2019 të datës 03.09.2019, e ka njoftuar ankuesen se nuk mundë të shqyrton dhe vendosë lidhur me ankesën A.nr.431/2019, të datës 26.07.2019, për shkak se Këshilli është jofunksional përkatësisht nuk ka anëtarë të mjaftueshëm për të marrë vendime, duke e udhëzuar ankuesen që ti shfrytëzoj mjetet juridike tjera përkatësisht hapjen e konfliktit Administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja _____ e pakënaqur me njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, lidhur me njoftimin nr.4045/2019 të datës 03.09.2019.

Ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 18.09.2023, ka nxjerr aktgjykimin A.nr.2945/2019 me të cilin aktgjykim e ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses , me të cilin aktgjykim e ka anuluar aktin administrativ/ njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit duke e obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendosë lidhur me ankesën A.nr.431/2019 të datës 26.07.2019 .

Kolegji i këshillit me rastin e shqyrtimit të ankesës sipas aktgjykimit A.nr.2945/2019 të datës 18.09.2023, bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht provave të ofruara nga palët në këtë procedurë në lidhje me vendimin me numër protokollit 14-070/01-132622/19 të datës 27.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës që kishte qenë objekt i ankesës të dorëzuar në këshill më datë 26.07.2019 , ankuesja kishte ushtruar padi më datë

09.12.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me që rastë kishte kërkuar anulimin e vendimit të apostrofuat më lartë të komisionit të ankesave të komunës së Prishtinës, ndërsa e njëjta gjykatë përmes aktvendimit A.nr.2945/19 të datës 17.09.2021 ka hedhë poshtë padinë si të palejuar bazuar në nenin 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me arsyetimin se vendimi me numër protokollit 14-070/01-132622/19 i datës 27.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës nuk është vendim përfundimtar në procedurë administrative.

Kundër aktvendimit A.nr.2945/19 të datës 17.09.2021 ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar të saj Av. _____ më datë 22.10.2021 ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa deri me datë 11.10.2023 kur është nxjerrë vendimi i këshillit A.nr.431/2019 me që rastë ishte pezulluar procedura në lidhje me këtë lëndë për arsyen e potencuar si më lartë përkatësisht deri në at datë të nxjerrjes së vendimit nga asnjë palë në procedurë nuk na është ofruar ndonjë dëshmi se është vendosë në lidhje me këtë ankesë nga Gjykata e Apelit dhe përderisa një lëndë është duke u trajtuar në Gjykatën e Apelit të Kosovës për të njëjtin objekt shqyrtimi, Kolegji i këshillit konstaton se në kuptim të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit"*, kishin ekzistuar rrethana të mjaftueshme që shqyrtimi i lëndës me numër A.nr.431/19 të datës 26.07.2019 të pezullohet deri në vendosjen përfundimtare nga Gjykata e Apelit të Kosovës, sipas ankesës së datës 22.10.2021 të parashtruar nga ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar të saj Av _____ kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2945/19 të datës 17.09.2021, pasi që objekti i shqyrtimit ishte i njëjtë dhe shërbente si parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore, ndërsa ishte potencuar edhe në këtë vendim se lënda mund të riaktivizohet në çdo kohë kur plotësohen kushtet ligjore për vendimmarrje meritore.

Ndërsa në lidhje me këtë vendim këshilli me datë 19.10.2023 përmes përfaqësuesit të autorizuar të ankueses Av. _____ ka pranuar shkresën me numër protokollit 6605/2023, me kërkesën për vazhdimin e procedurës sipas ankesës A.nr.431/2019 të datës 26.07.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës duke konsideruar me relevancë të theksuar ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.431/2019, e datës 26.07.2019, me numër protokollit 3302/2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 27.06.2019, me numër protokollit 14-070/01-132622/19, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 10.06.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 08.04.2019, i Komisionit Disiplinor; kërkesë e datës 07.05.2019; Përgjigje në kërkesë e datës 23.07.2018; kërkesë e datës 23.07.2018, për pushim të veçantë mjekësor; kërkesë e datës 23.04.2018, drejtuar Drejtorisë për Kadastër; Kërkesë për pushimin e veçantë; fletëlëshimi i datës 21.02.2019; Komisioni Konziliar i Reumatologëve i datës 11.11.2018; dëshmi nga Poliklinika Echo Diagnostik -A, e datës 18.03.2018; dëshmi nga Poliklinika Echo Diagnostika-A, e datës

17.08.2018; fletë lëshimi i datës 04.04.2019; Raport i Qendrës Spitalore i datës 10.04.2019; Raport Specialistik i datës 10.03.2019; Raport i Qendrës Spitalore i datës 19.04.2019; Raport Specialistik i datës 24.04.2019; e-maili i datës 03.09.2018; e-maili i datës 12.06.2018; e-maili i datës 20.11.2018; Raporti i datës 14.03.2019, për shkëljen disiplinore; Kërkesë për pushim e datës 11.04.2018; Kërkesa e datës 23.04.2018, për pushim pa pagesë; e-maili i datës 28.07.2019; Përshkrimi i detyrave të Punës; Formulari i Divizionit i Komisioneve Mjekësore; Njoftimi i datës 26.07.2018; Njoftimi i datës 23.07.2018; Aktgjykimi A.nr. 2945/2019, i datës 18.09.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Shkrese e datës 26.05.2023, me numër protokoll 4234, e lëshuar nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik i Universitar i Kosovës; Aktvendimi A.nr.2945/2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi me numër protokoll 8463/2022, i datës 27.12.2022, i KPMSHCK-së; Aktvendimi A.nr.2945/2019, i datës 22.11.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Padia e datës 05.12.2019, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi me numër protokoll 4045/2019, i datës 03.09.2019, i KPMSHCK-së; dëshmi fletë kthesë e datës 06.11.2019; Parashtresë e datës 19.10.2023, me numër protokoll 6605/2023; Përgjigje në ankesë e datës 08.08.2019, me numër protokoll 3474/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse;

Kolegji, fillimisht ka marr për bazë parashtresën e datës 19.10.2023 me numër protokoll 6605/2023 për vazhdimin e procedurës, sipas ankesës A.nr.431/219, të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankueses Avokati _____, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilën parashtresë i njëjti ka kërkuar që të vazhdohet me procesin e shqyrtimit të ankesës së ankueses A.nr.431/2019 të datës 26.07.2019, duke e njoftuar njëkohësisht Këshillin se Gjykata e Apelit të Kosovës, me datë 28.09.2022, përmes Aktvendimit AA.nr.1018/2021, ka miratuar si të bazuar ankesën e paditëses duke e prishë aktvendimin A.nr.2945/2019 të datës 17.09.2019 dhe lënda ishte kthyer në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative me qëllim që të vazhdohet procedura sa i përket kësaj padie që ndërlidhet me këtë çështje, ndërsa duke pasur parasysh faktin se bazuar në këtë aktgjykim Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 18.09.2023 kishte nxjerrë aktgjykimin A.nr.2945/2019 me që rast kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditëses përkatësisht në këtë rast ankueses, duke anuluar aktin administrativ/njoftimin e të paditurit në këtë rast këshillit A.nr.431/2019 të datës 03.09.2019 dhe ishte detyruar këshilli që të vendosë në lidhje me ankesën A.nr.431/2019 të datës 26.07.2019.

Me qenë se nga përshkrimi i situatës së më lartë kolegji i këshillit konstaton se kanë pushuar rrethanat për vazhdimin e procedurës së pezullimit të kësaj lënde dhe vazhdon me trajtim meritor të kësaj ankese.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, bazuar në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të Udhëheqëses së Drejtpërdrejtë-Udhëheqëses së Sektorit për Kadastër, me datë

08.04.2019, përmes vendimit me numër protokolli 14-118/02-81634/19 ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore „Ndërprerjeje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil“, të cilin masë disiplinore e ka vërtetuar edhe Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës, përmes vendimit të datës 27.06.2019, me numër protokolli 14-070/01-132622/19.

Kolegji i këshillit duke analizuar vendimin e Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës gjithnjë bazuar në shkresat e lëndës, konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, në rastin e shqiptimit të masës disiplinore „Ndërprerjeje e marrëdhënies së punës“, për nëpunësen civile/ankuesen ka vepruar pajtim me dispozitat nenin 71, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1,1.2 dhe 1.3, të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: „1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar“, si dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1,1.2 dhe 1.3, të Rregullores Nr. 04/2011, për Procedura Disiplinor në Shërbimin Civil, ku thuhet se; „1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar“.

Kolegji i Këshillit, bazuar në pretendimet ankimore të ankueses sa i përket çështjes që ka qenë objekt i vendimmarrjes në komision disiplinor, pasi që ka analizuar vendimin e Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, me të cilin vendim Komisioni Disiplinor në arsyetimin e vendimit kishte konstatuar se ankuesja nga data 14.06.2018, deri me datën 09.07.2018, ka munguar në punë, pa e njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë përkatësisht pa pasur leje nga zyrtarët përgjegjës, andaj kolegji i këshillit bazuar në shkresat e lëndës konstaton faktin se nuk është kontestuese fakti se ankuesja ka pasur probleme shëndetësore nga se kjo është e konfirmuar edhe me dokumentacion mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës, poashtu e njëjta ishte ftuar në mënyrë të rregullt për të marrë pjesë në seancë të komisionit disiplinor (fakt i konfirmuar në pjesën e parë të faqes 4 të ankesës së dorëzuar në këshill), ndërsa kolegji me kujdes ka shikuar provat e lëndës dhe me asnjë provë nuk është argumentuar pretendimi i palës ankuese se e njëjta kishte njoftuar organet përgjegjëse të Komunës së Prishtinës për mungesë nga puna për periudhën nga data 14.06.2018 deri më datë 09.07.2018, ndërsa kjo rrethanë në mënyrë direkte pranohet edhe nga ankuesja në përmbajtje të shkresës me numër protokolli 14-130/07-171369/18 të datës 16.07.2018 për pushim pa pagesë të parashtruar nga vet ankuesja, ku e njëjta ka kërkuar që kërkesa të aprovohet dhe të ketë efekt retroaktiv nga data 14.06.2018, me çka argumentohet fakti se e njëjta kishte munguar pa arsye gjatë kësaj periudhe. Poashtu kolegji i këshillit nga shkresat e lëndës që posedojmë në lëndë dhe që janë dorëzuar nga palët në procedurë nuk ka hasur në ndonjë shkresë përkatësisht dokumentacion mjekësor që ndërlidhet me periudhën kur ka munguar nga puna pa leje nga organet përgjegjëse të komunës përkatësisht periudhën 14.06.2018 deri më datë 09.07.2018, me çka argumentohet fakti se me të drejtë dhe bazuar në legjislacionin në fuqi të shërbimit civil Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës ka nxjerrë vendimin me datë 08.04.2019 me numër protokolli 14-118/02-81634/19 me që rast pretendimi i ankueses është i papabazuar në këtë aspekt.

Kolegji i këshillit nga ajo që u tha si më lartë konstaton se ankuesja, me veprimet e saja sa i përket mungesës në punë nga data 14.06.2018, deri me datën 09.07.2018, ka vepruar në

kundërshtim me nenin 59 paragrafi 1,2, me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të aplikuar në këtë periudhë ku thuhet së; *"1.Nëpunësit civilë janë të detyruar të jenë të pranishëm në vendin e punës në bazë të kushteve të emërimit të tyre dhe gjatë orarit të përcaktuar për funksionimin e institucionit punëdhënës. 2.Nëpunësit civilë janë të detyruar të respektojnë orarin e punës dhe ta shfrytëzojnë atë për kryerjen e detyrave të caktuara. Nëpunësit civilë janë të detyruar t'i informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës dhe të marrin autorizim për çdo largim nga vendi i punës. Mos informimi ose mungesa e pa lajmëruar nga vendi i punës konsiderohet braktisje e vendit të punës dhe dënohet në përputhje me ligjin"*, si dhe në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 05/2010, për Orarin e Punës në fuqi në këtë kohë, ku përcaktohet se; *"1.Gjatë orarit të punës të gjithë nëpunësit civil janë të obliguar të jenë në vendin e punës , Çdo nëpunës civil shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose ne regjistrin elektronik 2. Mospërfillja e orarit të punës, paraqet shkelje disiplinore"*.

Sipas vlerësimit të Kolegjit të këshillit, masa disiplinore *"Ndërprerje e marrëdhënies së punës"*, për ankuesen _____ nga Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, e shqiptuar përmes vendimit të datës 08.04.2019 me nr. 14-118/02-81634/19 ,është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse është marrë në pajtim me nenin 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil ku thuhet citohet:*"1.4. Ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension"*.

Kolegji i këshillit nga përmbajtja e konstatimit si më lartë, duke analizuar me kujdes vendimin nr.14-070/01-132622/19 i datës 27.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës që është atakuar me këtë ankesë dhe ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Prishtinës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të apostrofuat si më lartë drejtë ka konstatuar gjendjen faktike dhe me rastin e vendimmarrjes ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ,me që rast pretendimi i ankueses se me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi nuk janë marrë parasysh faktet, rrethanat dhe propozimet e ankueses përmes kësaj ankese që rezulton me këtë vendim të komisionit disiplinor, kolegji i këshillit konstaton se këto pretendime janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara.

Me qenë se nga shkresat e lëndës konstatohet pa asnjë mëdyshje se ankuesja me asnjë provë nuk ka arrit të provoj pretendimin e sajë se e njëjta ju ka përmbajtur dispozitave të ligjit në fuqi në at periudhë me rastin e mungesës së arsyeshme nga puna dhe lejes nga zyrtarët kompetentë të Komunës së Prishtinës dhe me qenë se nga ajo që u tha si më lartë është konstatuar nga kolegji i këshillit se ka pasur argumente të mjaftueshme në shkresat e lëndës me që rast është konstatuar se mungesa nga puna nuk ishte me leje të organeve kompetente dhe se kjo nuk ishte e argumentuar edhe me ndonjë dokument mjekësor që mbulon këtë periudhë të mungesës nga puna dhe se mungesa nga punë për një periudhë relativisht të gjatë përkatësisht nga data nga data 14.06.2018, deri me datën 09.07.2018 dhe se kjo mungesë nga puna është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil përkatësisht Ligjin Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dispozitat e nenit 71, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1,1.2 dhe 1.3, nenin 59 paragrafi 1,2, nenin 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në

Shërbimin Civil, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, andaj mbi bazë të këtij argumentimi faktit dhe juridik, kolegji i këshillit nuk u lëshua në pretendimet tjera ankimore nga se nuk ishin me relevancë për vendim ndryshe nga ky si është marrë si në dispozitiv të këtij vendimi, me që rast ka lënë në fuqi vendimin nr.14-070/01-132622/19 të datës 27.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, si vendim i drejtë dhe i bazuar në legjislacionin në fuqi të shërbimit civil si dhe dispozitat e ligjit të procedurës së përgjithshme administrative dhe njëkohësisht Shfuqizon vendimin A.nr.431/2019 të datës 11.10.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes së cilit vendim ishte pezulluar procedura në lidhje me ankesën A.nr.431/2019 të datës 26.07.2019.

Andaj, Kolegji i këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës përkatësisht konstatimeve në këto shkresa dhe arsyetimit/konstatimeve si më lartë si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.431/2019, datë 01/12/2023

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses ,Avokatit
- Kryetarit të Komunës se Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së